



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 paragrafit 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/2019) dhe nenit 40 dhe nenit 41 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme: KSHPK) në seancën e 83-të të mbajtur më 27.02.2023 ka miratuar

Vendim

Procedura për lëndën me nr. 08-3906 / 1 datë 09.10.2021, NDËRPRITET.

Në bazë të dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm të KSHPK-së për lëndën me numër 08-3906/1 datë 09.10.2021.

Lënda me numër 08 –3906/1 të datës 09.10.2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 08-3906 / 1 të datës 09.10.2021 është formuar me vetiniciativë .

Nga mbikëqyrja e evidencave të saj, KSHPK-ja ka konstatuar se personi ----- në afatin e paraparë me ligj prej 30 ditësh pas përfundimit të funksionit së anëtarit në ----- ---- nuk ka dorëzuar fletë anketuese në Komisionin Shtetëror për Parandalim e Korrupsionit.

KSHPK-ja përpiloi procesverbal për kundërvajtje dhe urdhërpagesën e konstatuar ia dorëzoi personit _____. I njëjti më 23.09.2022, e ka paguar gjobën në masën e përcaktuar në urdhërpagesë kundërvajtëse.

KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprimin e saj kompetent në rastin konkret.

Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Përgatiti: Mr. Antonija A. Tasevska
Miratoi: Shemshi Sallaj, anëtar

**KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
NËNKRYETAR,
Katica Nikolovska**

